

RAPORT 6-MUJOR I PUNËS - Dropull

Hyrje

Ky raport paraqet një përmbledhje të punës së kryer në kuadër të evidentimit të objekteve me vlera kulturore, historike dhe arkitektonike në disa fshatra të zonës së dropullit. Puna është fokusuar në identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin paraprak të objekteve që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore lokale dhe që kanë potencial për t'u propozuar si monumente kulture.

Qëllimi i punës

Evidentimi i objekteve që mbartin vlera historike, arkitektonike, urbanistike apo etnografike. Gjithashtu, puna synon krijimin e një baze paraprake informacioni me elementet që rrugojnë ende vlera dhe të cilat mund të propozohen që të shtohen listës së monumenteve të kultures.

Përshkrimi i veprimtarisë së kryer

Vizitat dhe hulumtime për fshatrat : **Dervician, Frashan, Goranxi, Grapsh, Jergucat, Lugar.**

Gjatë kësaj periudhe është realizuar punë në terren në disa fshatra, ku janë identifikuar dhe dokumentuar objekte të ndryshme me interes kulturor. Procesi ka përfshirë vëzhgim të drejtpërdrejtë të objekteve, regjistrim të gjendjes së tyre aktuale, si dhe mbledhje informacioni nga banorët të zonës, të cilët kanë kontribuar me të dhëna mbi historikun dhe përdorimin e tyre ndër vite.

Objektet e evidentuara përfshijnë kryesisht ndërtesa tradicionale banimi, objekte kulti, struktura ndihmëse dhe elementë të tjerë të trashëgimisë së ndërtuar, të cilat reflektojnë zhvillimin historik dhe karakterin kulturor të zonës.

Vështirësi dhe problematika

Gjatë realizimit të punës janë hasur disa vështirësi, kryesisht të lidhura me gjendjen fizike të dëmtuar të disa objekteve, mungesën e dokumentacionit historik të shkruar, si dhe ndërhyrjet e pakontrolluara që kanë ndikuar në humbjen e elementeve origjinale. Në disa raste, qasja në objekte ka qenë e kufizuar për shkak të përdorimit privat ose mungesës së mirëmbajtjes.

1) Pjesa e fshatrave të vjetra.

Per sa i përket fshatrave të vjetra problematikën kryesore të tyre ishte evidentimi në disa prej fshatrave, ndërsa në fshatrat si Derviciani, apo Jergucat problematika përveç terrenit ishte dhe prania e qenve të stanit që e bënin të vështirë vizitën dhe qëndrimin për një kohë të gjatë në vend.

2) Mungesa e aksesit në objektet private

Në disa fshatra popullsia ka emigruar, gjë që ka bërë të pamundur hyrjen në shumë objekte. Gjatë vizitave në terren, problematika kryesore ishte mungesa e banorëve, çka bëri që të mos kishim akses në disa ndërtesa dhe të mos merrnim informacion të detajuar për elementët e brendshëm që mund të mbartnin vlera. Këtu mund të përmendim, për shembull, oxhaqe të veçanta, piktura murale të brendshme, tavanë të dekoruar apo elemente të tjera që kanë rëndësi për dokumentim dhe ruajtje.

3) Rrënojat dhe gjendja e degradimit

Një pjesë e objekteve aktualisht ndodhen në gjendje rrëni ose pjesërisht rrënoja. Për shkak të emigracionit të madh në zonën e Dropullit, shumë shtëpi janë braktisur, duke bërë që ndërtimet të degradojnë me kohën dhe të humbin pjesërisht apo tërësisht elementët e tyre arkitektonikë dhe kulturorë.

Rezultatet paraprake

Si rezultat i punës së kryer, është hartuar një listë paraprake e objekteve me vlera kulturore, një pjesë e të cilave vlerësohen si të përshtatshme për t'u propozuar për marrjen e statusit **Monument Kulture**. Këto objekte paraqesin interes të veçantë për shkak të nivelit të lartë të autenticitetit, përdorimit të teknikave tradicionale të ndërtimit, ruajtjes së elementeve origjinale, si dhe rolit të rëndësishëm që kanë pasur në jetën sociale dhe kulturore të komunitetit.

Deri më tani, nga vizitat në terren të realizuara në fshatrat e sipërpërmendur, janë identifikuar një sërë objektesh, të cilat paraqiten dhe përshkruhen më poshtë.

1) Lemenjte ne fshatrat : Frashtan, Lugar, Grapsh, Jergucat

Në fshatrat e vizituara deri më tani në zonën e Dropullit janë evidentuar **Lemenjë** në disa nga fshatrat e sipërpërmendur. Një pjesë e tyre ndodhen në gjendje relativisht të mirë ruajtjeje, ndërsa të tjerat identifikohen me vështirësi për shkak të degradimit dhe humbjes së elementeve origjinale.

Fshati që përfaqëson tipologjinë prototip të Lemenjve është **Grapshi**, ku në kodrën jugore të fshatit gjendet një përqendrim i konsiderueshëm i tyre. Në përgjithësi, në zonën e Dropullit, për shkak të relievit, disa fshatra paraqesin të njëjtat karakteristika planimetrike: vendbanimi shtrihet përgjatë shpatit, ndërsa Lemenjtë janë të vendosur në skajet e tij. Të njëjtën tipologji paraqet edhe fshati **Jergucat**, ku Lemenjtë janë të përqendruar masivisht në pjesën jugore të fshatit.

Gjithashtu, në fshatrat **Frashtan** dhe **Lugar**, në zonat periferike, janë evidentuar Lemenjtë e fshatit, megjithëse në numër më të kufizuar dhe në gjendje më të dobët ruajtjeje.


Lemenjtë janë ndërtuar me muraturë guri të thatë, tipike për zonën. Në pjesën e sipërme gjendej plani rrethor i lemit, ndërsa në pjesën e poshtme zhvillohej objekti, zakonisht dy kate, të ndara me dyshe me druri ndërmjet kateve, ose në disa raste njëkatëshe. Dritaret e vogla shërbenin si lidhje funksionale midis lemit dhe objektit, duke mundësuar kalimin e drithit.

Lugar





Frashtan



Grapsh





Jergucat





Me interes të veçantë paraqitet fakti që Lemenjtë të cilët ruajnë ende muraturën dhe formën e rregullt gjeometrike të pastrohen, dhe në një fazë të dytë të ndërhyhet me restaurime konservuese. Gjithashtu, evidentimi i numrit të Lemenjve paraqet rëndësi të veçantë, pasi ky element pasqyron jetën ekonomike dhe sociale të fshatit, kulturat bujqësore të kultivuara, si dhe numrin e banorëve ndër vite.

2)Banesa me me tipologji dhe elemete te vecante.

Dervician, Frashtan, Goranxi, Grapsh, Jergucat, Lugar.

Për sa i përket fshatrave të përmendura më sipër, mund të konstatohet se tipologjitë e ndërtimit janë përgjithësisht të ngjashme. Ndërtesat janë ndërtuar kryesisht me gur të bardhë, të lidhur me llaç, ndërsa objektet ndihmëse dhe muret rrethues realizohen me gur të bardhë të papunuar, pa material lidhës.

Banesat kanë pësuar një proces evoluimi ndër vite, ku vërehen shtesa dhe ndërtime të mëvonshme, të cilat kanë shërbyer kryesisht si tualete dhe hapësira kuzhine.

Në të gjitha këto fshatra evidentohet në mënyrë masive tipologjia e banesave dykatëshe, me shkallë të brendshme dhe nga dy ambiente për secilin kat. Shkallët pozicionohen ndërmjet këtyre ambienteve, ndërsa në pjesën qendrore ndodhet ballkoni, i cili me kalimin e kohës është transformuar nga ballkon druri në ballkon me strukturë betoni të armuar.

Një veçanti e arkitekturës së Dropullit evidentohet në fshatin **Goranxi**, ku spikasin banesat tip **kullë**, tipologji që nuk haset në pjesën tjetër të kësaj zone.

Në fshatrat **Goranxi**, **Dervician**, **Jergucat** dhe **Lugar** vërehen gjithashtu banesa dykatëshe, ku kati i parë shërben si kat banimi, ndërsa kati përdhet funksionon si katua. Në këtë nivel ruheshin zahiretë e dimrit dhe në një pjesë të tij mbaheshin edhe bagëtitë. Dy katet lidhen me njëra-tjetrën përmes shkallëve të jashtme, ndërsa sheshpushimi në krye të shkallëve shërbente si **divan**.

Në disa prej këtyre fshatrave hasen edhe banesa me një krah, por po ashtu dykatëshe. Ndërsa në fshatin **Dervician** evidentohet një banesë trekatëshe, ku në katin e fundit dallohen mure të ndërtuara me **çatmâ**, element i veçantë për zonën, si dhe prania e një **erkeri** në fasadën ballore të objektit.


Dervician





Frashtan





Goranxi







Grapsh



Jergucat





Lugar



3)Portat

Në fshatrat e Dropullit vërehet se portat e banesave përbëjnë një element me rëndësi të veçantë arkitektonike dhe kulturore. Gjatë vizitave në terren janë dokumentuar disa prej tyre, ku konstatohet se janë ndërtuar kryesisht prej guri, ndërsa në disa raste paraqesin elemente të skalitura me simbolika të veçanta. Gjithashtu, në disa prej portave evidentohet prania e **sofave**, element arkitektonik i përhapur gjerësisht në të gjithë Luginën e Gjirokastrës, i cili ka shërbyer si hapësirë ndërmjetëse me funksion social dhe praktik.

Dervician



Goranxi







Jergucat





Lugar



4)Kalldreme.

Nga burimet e terrenit rezulton se në të gjitha këto fshatra rrjeti rrugor ka qenë në masë të madhe ose pjesërisht me kalldrëm. Me kalimin e kohës, rrugët janë transformuar për të përmbushur nevojat e komunitetit, dhe sot shumica e tyre janë të asfaltuara ose të mbuluara me beton.

Në të vetmet raste ku kalldrëmet janë ende të ruajtura, bëhet fjalë për rrugica të ngushta, ku aksesit për makinat është i kufizuar.

Në fotot më poshtë shfaqen shembuj të rrugicave me kalldrëm në gjendje të mirë, si dhe rrugica pothuajse të shkatërruara.

Goranxi



Lugar



5) Banesa me influence te ndryshme jo karakteristike per zonen.

Goranxi

Duke qenë se e gjithë zona e Dropullit ka patur një valë të konsiderueshme emigrimi të banorëve gjatë viteve, kjo ka ndikuar edhe në mënyrën e zhvillimit të ndërtimeve. Banorët, kur ktheheshin në fshatra, shpesh sillnin ndikime arkitektonike nga vendet ku kishin jetuar.

Një shembull tipik është në fshatin **Goranxi**, ku një ambient i ri është shtuar objektit kryesor, i përshtatur si **pijetore**.

Megjithëse ky objekt shtesë është suvatuar dhe i lyer me bojë të verdhë — e cila nuk është karakteristike për zonën — ai është ndërtuar përsëri me **muraturë guri**, ndërsa çatia është e mbuluar me **rasa guri**, duke ruajtur kështu elementët tradicionalë të ndërtimit.




6) Fshatrat e vjeter

Me rëndësi të veçantë në Luginë janë edhe fshatrat e vjetër të Dropullit, të vendosur mbi kodrat e fshatrave aktualë. Në disa raste, emrat e tyre janë të ngjashëm me emrat e fshatrave të sotëm, ose lagjet e tyre përkojnë me toponime të fshatrave të vjetër.

Për shkak se këto fshatra janë braktisur herët dhe ndërtimi i tyre është bërë me muraturë guri të thatë, pa lidhës, strukturat janë degraduar dhe në terren shpesh gjejmë vetëm pirgje gurësh.

Megjithatë, këto fshatra kanë një rëndësi të madhe, pasi reflektojnë vazhdimësinë e jetës në Luginë dhe japin informacion mbi numrin e banorëve dhe zhvillimin historik të zonës.


Dervician





Jergucat



Lugar



Frashtan





Objektet e paraqitura në foto përfaqësojnë, nga këndvështrimi ynë paraprak, vlera të veçanta për zonën. Gjithashtu, në këtë raport mund të përfshihen edhe objekte të tjera, të cilat në një fazë të dytë do të jenë më të aksesueshme dhe të dokumentueshme.